



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURES  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 136 Prot.

Tiranë, më 30.01 2018

**VENDIM Nr. 5, datë 18.01.2018**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.1, datë 18.01.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtimi i HEC "Mercurth 2", në Zallin e Mercurthit, Rrethi Mirditë, Qarku Lezhë* -subjektet "J.V "PI.BI.PI" sh.p.k. & "KLIMA SUPERIOR" sh.p.k. & "Tanush Jaku", realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtimi i HEC "Mercurth 2", në Zallin e Mercurthit, Rrethi Mirditë, Qarku Lezhë* -subjektet "J.V "PI.BI.PI" sh.p.k. & "KLIMA SUPERIOR" sh.p.k. & "Tanush Jaku", realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj.
2. Subjektet "J.V "PI.BI.PI" sh.p.k. & "KLIMA SUPERIOR" sh.p.k. & "Tanush Jaku", duhet të lidhin paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Ndërtimi i HEC "Mercurth 2", në Zallin e Mercurthit, Rrethi Mirditë, Qarku Lezhë", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E KULTURES**  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**RUBINA ZOTO**